



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice
Kabineti i Ministrat të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 105/2020
Datë: 28/11/2020

Në mbështetje të nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (08.06.2020), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 07/2020 (16.06.2020) si dhe në përputhje me nenin 36, (paragrafi 3) të Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i Parave Publike, Ministri i Drejtësisë, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa nr. 29-20, dt. 25.09.2020 e Komunës së Preshevës për ndarjen e mjeteve financiare për rregullimin e hapësirave të Gjykatës Themelore në Preshevë, në vlerë prej njëzetë mijë euro (20.000 €).
2. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi ndahen nga programi 379 00, nga kategoria e shpenzimeve 20- Subvencione dhe Transfere.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë që mjetet nga pika 1 e këtij vendimi t'i transferojë në Komunën e Preshevës, në pajtim me procedurat përkatëse të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.
4. Obligohet Komuna e Preshevës që brenda tre (3) muajve pas pranimit të mbështetjes financiare të raportojë në Ministrinë e Drejtësisë, për shpenzimin e mbështetjes financiare.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komuna e Preshevës më datë 25.09.2020 me kërkesën me nr. 29-20 i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë, me kërkesë për ndarjen e mjeteve financiare për rregullimin e hapësirave të Gjykatës Themelore në Preshevë duke pas parasysh që objekti i kësaj gjykate nuk është në funksion qysh prej vitit 2014 dh se kjo hapësirë ka nevojë për një për një intervenim të renovimit të saj në mënyrë që të ketë kushte optimale për mbajtjen e seancave gjyqësore në këtë objekt.

Marrë parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e punës, Ministria e Drejtësisë ka shqyrtuar këtë kërkesë dhe ka aprovuar një mbështetje financiare në vlerë prej njëzetë mijë (20.000) euro. Kjo është një mbështetje financiare e cila bazohet në situatat përjashtuese të zbatimit të Rregullores MF-NR. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, ministri i Drejtësisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Selim SELIMI
Ministër i Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Komunës së Preshevës;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Arkivit të MD-së.